Prishtinë, 17.10.2023
Kodi i ZRRE-së: V_1774_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2447_08_23** i dt.31.08.2023;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **27.09.2023.**

në seancën e mbajtur më datë 17.10.2023 nxori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin B.O nga Komuna e Prizrenit, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

II. MBETET në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2447_08_23 i dt.31.08.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 31.08.2023 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2447_08_23 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 18.05.2023 lidhur me kontestimin e faturës nr. 0622159586DPZ-14657 date 21.06.2022, për shkak të dyshimit ne faturimin jo te saktë e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 7616313.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se faturimi i konsumatorit është real;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2447_08_23 i datës 31.08.2023 për konsumatorin **B.O**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 17.10.2023 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e KESCO se vendimin nr. ZRRE/DMK_ V_2447_08_23 i datës 31.08.2023 i Departamentit per Mbrojtjen e konsumatorëve nuk është i drejt, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Procesverbali për pranimin e instalimit elektrik nr. 0104248 datë 12.05.2022; Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0027865 datë 12.05.2022; Faturën nr. 0622159586DPZ-14657 date 21.06.2022; ankesën e konsumatorit në KESCO datë 20.06.2022, Procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9961 datë 10.08.2022; korrigjimi nr. 0622159586DPZ-14657 date 21.06.2022; Përgjigja e KESCO-s e datës 18.05.2023; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 05.06.2023; Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_ V_2447_08_23 i datës 31.08.2023, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, listat e leximi, dhe dy videot e dorëzuara nga konsumatori ka gjetur se nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Në shqyrtim e sipër të rastit, ZRrE ka vërejtur se me datë 12.05.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për pranimin e instalimeve elektrike kanë inspektuar piken matëse te konsumatorit ku kanë bere pranimin e instalimit elektrik per njehsorin elektrik nr. 7676313 me gjendje TL=99226 kWh dhe TU=65583 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar ne procesverbal se aktivizimi i njehsorit behet sipas kërkesës. Po te njëjtën ditë ekipi i njëjtë i KEDS-it kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 7676313 me gjendje TL=99226 kWh dhe TU=65583 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20092799 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar ne procesverbal se ndërrimi behet sipas procesit nr. 0104249. Bordi i ZRRE ka analizuar dy procesverbalet dhe konstaton se ne asnjërin procesverbal nuk është evidentuar se njehsori elektrik nr. 7676313 është i dëmtuar ne çfarëdo forme apo qe ka dyshime ne çrregullim te matjes.

Me datë 10.08.2022 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7676313 me gjendje te shpenzimeve TL=99226 kWh dhe TU=65583 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllombat(vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka. Ne brendi te njehsorit komisioni ka vërejtur se ka shenja të fërkimit ne disk dhe gjatë këtij fërkimi është krijuar pluhur, mirëpo nuk ka ndonjë parregullsi.

Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike, transaksioneve te konsumatorit vërtetohet se konsumatori ka qenë aktiv nga fillimi pra periudha 08/2002 deri ne periudhën 06/2013 kur edhe bere pasivizimi me gjendje te shpenzimeve TL=33096 kWh dhe TU=25804 kWh kurse është aktivizuar ne periudhën qershor 2022, ku ekipet përgjegjëse kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 7676313 me gjendje TL=99226 kWh dhe TU=65583 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20092799 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Gjatë analizës se listave te leximit është vërtetuar se lexuesi i KEDS-it ne asnjë rast nuk e ka evidentuar se nga periudha 06/2013 e tutje deri ne periudhën 06/2022 konsumatori ka shpenzim te energjisë elektrike. Konsumatori me datë 01.08.2023 ka ofruar dy video me te cilat vërtetohet se njehsori elektrik me nr. 7676313 ne ngarkesë benë matje te pakontrolluar ne dy tarifat. Po ashtu ne baze te te dhënave te ofruara vërehet se gjendja e shpenzimeve ne ato momente ne tarifën e lartë ka qenë TL=63403 kWh dhe tarifa e ulet TU=95637 kWh, e cila gjendje nuk përputhët me gjendjet e evidentuara ne tri procesverbalet e KEDS, procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik nr. 0104248 datë 12.05.2022 dhe procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0027865 datë 12.05.2022 si dhe procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9961 datë 10.08.2022. Bordi i ZRRE ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike te konsumatorit me njehsorin elektrik nr. 20092799 dhe konstaton se totali i shpenzimeve per periudhën 06/2022 deri ne periudhën 07/2023 është **7,604 kWh** kurse per periudhën një vjeçare 06/2022 deri ne periudhën 06/2023 është **7,130 kWh**. Nen supozimin se konsumatori ka qenë i kyçur edhe përkundër pasivizimit kWh e faturuar pra **105,909 kWh** do te duhej qe te shpenzoheshin per një përudhë 14.85 vjet.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 21.06.2022 i ka dërguar konsumatorit faturën e energjisë elektrike me **105,909 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **11,435.62 €.** Bordi i ZRRE ka analizuar faturën kontestuese te konsumatorit, nr. 0622159586DPZ-14657 date 21.06.2022 dhe konstaton se faturimi i konsumatorit per këtë periudhë ne asnjë rast bazuar edhe ne shpenzimet e tanishme si dhe para pasivizimit te njehsorit nuk mund te paraqesin shpenzim te konsumatorit. Bordi i ZRRE po ashtu ka shqyrtuar edhe korrigjimin nr. 54473DPZ-14657 datë 06.10.2022 në vlerë **-2,476.15€** dhe konstaton se Departamenti i faturimit ne KESCO ka gabuar duke mos marr per bazë qe korrigjimi është dashur te behet per periudhën 06/2013 deri ne periudhën 05/2022 kur edhe është bere ndërrimi i njehsorit elektrik dhe jo vetëm per periudhën gjashte mujore 12/2021 deri ne periudhën 05/2022. Bazuar ne ketë konstatohet se Departamenti i faturimit në KESCO ka vepruar ne kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme),3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese*.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 17.10.2023 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrik, listat e leximit, procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik nr. 0104248 datë 12.05.2022,procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0027865 datë 12.05.2022, procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9961 datë 10.08.2022, fatura nr. 0622159586DPZ-14657 date 21.06.2022, korrigjimi nr. 0622159586DPZ-14657 date 21.06.2022, video incizimet e dorëzuara nga pala si dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

_____
Ymer Fejzullahu, Kryesues

_____
Lutfije Dervishi, anëtare

_____
Gani Buçaj, anëtar

_____

Arta Isufi, Anëtare

_____

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit B.O dhe
- Arkivit të ZRRE-së.